

Zgjidhni një nga tre seritë dhe realizoni hapësirën tuaj sipas shijes personale



Përparësi të pakrahasueshme

- / Zgjedhje e shkëlqyeshme nga modelet e dizajnit dhe deri tek mundësitë e pakufizuara të personalizimit.
- / Fuqi e lartë dhe qëndrueshmëri ekstreme ndaj kushteve të vështira të motit dhe ngarkesave të forta të erës.
- / Dimensione të mëdha për të mbuluar nevojat e veçanta të projektit, veçanërisht në rastin e portave ku kërkohet kalimi i papenguar i automjeteve.

- / Estetikë e pakrahasueshme, dizajn i detajuar, tipologji komplekse të bëra 100% prej alumini.
- / Nivele të larta të inovacionit, me teknika dhe materiale moderne, kombinime inteligjente dhe ndërtime unike.

ALB APRIL 2021

TË JASHTME
Krijoni hapësira të jashtme spektakolare, duke përdorur qasjen holistike të ALUMIL.



ALUMIL ALBANIA SHPK
Highway Tirane-Durres, km 7
Kashar, 1053, Tirana, Albania
Tel.: +355 48 240 230
Fax: +355 48 240 235
info.al@alumil.com

**HEAD OFFICES
& SHOWROOM - THESSALONIKI**
Gogousi 8, Eftkarpia
Thessaloniki - GR 564 29
Tel.: +30 23 13 01 1000
Fax: +30 23 10 692473
E-mail: info@alumil.com

HEADQUARTERS & FACTORY
KILKIS INDUSTRIAL AREA
Kilkis - GR 611 00
Tel.: +30 234 10 79300
Fax: +30 234 10 71988
E-mail: info@alumil.com

alumil

www.alumil.com

alumil

SMARTIA
Sisteme Rrethimi & Porta

- ▶ SMARTIA
FC10
- ▶ SMARTIA
FC60
- ▶ SMARTIA
FC80



ALUMIL ofron tre tipe sistemesh rrethimi, me estetikë të shkëlqyer dhe me shumë përfitime, të cilat ndryshojnë në termat e vendosjes së profileve mbushës.

Ofrojnë opsione të shumta për performancë të lartë të sistemeve të rrethimit për të rrethuar hapësirën tuaj në mënyrën më elegante të mundshme.

- ▶ Mundësia e vendosjes së profileve mbushëse vertikalisht ose horizontalisht, të bashkëngjitura ose si dekor midis kolonave.
- ▶ Profilët mbushëse prej alumini të kombinuara me materiale të tjera si dru i përbërë, xham, fleta të përforcuara prej alumini etj.
- ▶ Porta me hapje dhe mbyllje, totalisht të automatizuara dhe me propozime të shumta dizajni.
- ▶ Zevëndësimi i blloqeve prej betoni dhe strukturave prej çeliku me profile prej alumini, duke shmangur problemet e bojës, ndryshkut dhe mirëmbajtjes.



Krijoni stilin prej alumini sipas estetikës suaj personale



SMARTIA FC60 është një sistem rrethimi prej alumini me profile mbushës të zgjedhjes suaj, të bashkëngjitura horizontalisht në blloqe. Ajo ofron një rezultat linear minimal, të vazhdueshëm, dhe padyshim është një sistem rrethimi që mund të përmirësojë stilin e hapësirës suaj, prandaj rekomandohet plotësisht për hotelet, rezidencat, shtëpitë, etj.

Seria karakterizohet nga qëndrueshmëri e lartë dhe përmasa të mëdha konstruksioni, duke ofruar të gjitha opsionet e portës (me rrëshqitje, kanat/dopio kanat me hapje).

Përparësi të pakrahasueshme

- / Dizajn i shkëlqyeshëm, minimal dhe linear, pa pika fiksime të dukshme.
- / Gama e gjerë e zgjidhjeve dhe opsioneve të dizajnit, veçanërisht në profilet mbushës prej alumini.
- / Kombinime unike me materiale druri të përbëra, të tilla si profilet mbushës hibrid WOODALUX.
- / Qëndrueshmëri e lartë dhe mundësi për hapësira të mëdha.
- / Projekt i veçantë për lehtësi konstruksioni.

Smartia FC80 është një sistem rrethimi i sofistikuar që vjen në formë dhe konfigurime të ndryshme. Ofron shumëllojshmëri të zgjidhjeve të aplikueshme në terma teknike dhe estetike. Kështu, mund të jetë një paisje e vlefshme për çdo arkitekt, pjesë e rëndësishme e çdo projekti rrethimi dhe një propozim unik për kërkesa të veçanta.



Përdorimi i pivot me hapje dhe shtyllave 120mm ose 250mm, për panele të mëdha portash dhe 100% rezultat prej alumini (pa shtylla prej betoni).

Karakteristikat kryesore të sistemit janë instalimi i mbushjeve midis shtyllave dhe diapazoni i gjerë i materialeve dekorative të aplikuar.


Për më tepër, sistemi shquhet për qëndrueshmërinë e tij të pakrahasueshme - profilet të përfunduara dhe pajisje shtesë të rënda - që lejojnë distancë më të gjerë midis shtyllave dhe portave shumë më të mëdha të një performace të qëndrueshme.




Opsione të shumta ndriçimi LED përgjatë profileve mbushëse, shtyllave, parmakëve, dorezave etj.

Përparësi të pakrahasueshme

- / Nivelet më të larta të qëndrueshmërisë për konstruksione në shkallë të gjerë, veçanërisht për portat, gjë që e bën kalimin e automjetit shumë më të lehtë (deri në 6.0 m hapësirë)
- / Mundësia e krijimit të sipërfaqeve pa hapësirë dhe ndonjë problem që lidhet me ngarkesën e erës (më shumë se 2.0 m lartësi).
- / Gama e gjerë e zgjidhjeve dhe niveli i lartë i personalizimit, në sajë të bollëkut të profileve dhe zgjidhjeve teknike.



Porta me rrëshqitje është në dispozicion si një alternativë ndaj portës me hapje (kanat tek ose dopio), duke ofruar besueshmëri të lartë dhe automatizim të plotë.



Shumëllojshmëri kapakësh dekorativë (piramidë, trekëndësh ose stil i sheshtë) i disponueshëm në ngjyra të qëndrueshme.

- / Nivele të larta të inovacionit dhe diferencimit, duke përdorur materiale moderne (WOODALUX), korniza inteligjente, mundësi të shumta ndriçimi, mbivendosje, etj.
- / Zëvendësimi - zakonisht kërkohet – i elementëve të betonit (kolona, hijezuesit) me rrethime dhe profile pergola prej alumini për 100% rezultat alumini.

Propozime unike për rezultat minimal absolut

ALUMIL kompletion zgjidhjet e rrethimit me **SMARTIA FC10**, një sistem që karakterizohet nga një dizajn unik dhe minimal me linja të thjeshta vertikale.

Në të njëjtën kohë, ky sistem është një propozim alternativ për ndërtime të ngjashme rrethuese lineare të bëra prej çeliku, pa problemet e veshjes me pudër, korrozionit dhe mirëmbajtjes që shoqërojnë këtë të fundit.

Përparësi e pakrahasueshme

- / Stili i veçantë, që nuk shihet zakonisht në sistemet e rrethimit të bëra prej alumini.
- / Rezultati përfundimtar i jashtëzakonshëm kur kombinohet me shufrat WOODALUX.
- / Zëvendësim i suksesshëm i konstruksioneve përkatëse prej çeliku.
- / Ndërtime rrethimi të gjata pa probleme të qëndrueshmërisë dhe ngarkesës së erës.
- / Mënyrë inteligjente dhe efektive e lidhjes së profileve mbushëse - veçanërisht në anën e sipërme - e cila mbetet pa u vënë re.